



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 183/2 prot.

Tiranë, më 29.5.2024

- Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 3.6.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 20.4.2021, është njoftuar vendimi nr. 352, datë 1.3.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë [...].*

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor 15 ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit, pasi ka çmuar se juridiksioni kontrollues dhe rivlerësues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji), do të duhet të ushtrohet në rastin konkret.

Komisioneri Publik, duke i qëndruar shkaqeve të trajtuara gjerësisht në ankimin e datës 5.5.2021 kundër vendimit nr. 352/2021 të Komisionit, para këtij trupi gjykues, për efekt të këtij gjykimi, parashtron në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

I. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Pasuritë, për të cilat Komisioneri Publik, në ankimin e datës 5.5.2021, ka parashtruar nevojën për hetim të mëtejshëm, janë respektivisht: (i) pasuri e paluajtshme e llojit “apartament banimi” ndodhur në Vlorë, me sipërfaqe 82 m², nr. **/*+*, blerë në vitin 2002,

me vlerë të deklaruar prej 6.000.000 lekë dhe burim krijimi të deklaruar: “*Të ardhura nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit, kursimet familjare dhe kursime të prindërve të bashkëshortit*”; dhe (ii) pasuri e paluajtshme e llojit “apartament banimi” ndodhur në Tiranë, me sipërfaqe totale 121,6 m², me vlerë 60.800 euro dhe burim krijimi të deklaruar: “(a) 1.000.000 lekë, të përfituar nga shitja e pjesës time takuese në apartamentin e privatizuar; (b) 30.000 euro, të marra hua; (c) 2.700.000 lekë, të dhëna nga prindërit e bashkëshortit; (d) kursime nga të ardhurat”. Shumat e deklaruara në formën e dhuratës arrijnë vlerën 8 milion lekë.

2. Në lidhje me shkakun ankimor mbi ligjshmërinë e burimeve të shumave të deklaruara, të përfituara “*në formën e dhurimeve nga persona të tjerë të lidhur*” (prindërit e bashkëshortit në rastin konkret), trajtuar në prgr. 14.1 e vijues në ankimin e datës 5.5.2021, Komisioneri Publik paraprkasht vlerëson të nënvizojë evoluimin e jurisprudencës së Kolegjit, për sa kërkuar mbi verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhuruar sipas kërkesës së nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Kolegji, tashmë, ka interpretuar në jurisprudencën e tij orientuese, verifikimin e burimit të ligjshmërisë së shumave të dhuruara, parë kjo e fundit në raport me pagimin e tatimit për to¹. Në të tilla rrethana, orientimi i dhënë nga Kolegji duket se ezauron këtë shkak ankimi.

3. Në lidhje me shkaqet e tjera ankimore lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik konstaton se, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit mbi çështjet e trajtuara gjerësisht në ankimin e datës 5.5.2021, lind nevoja e rivlerësimit nga ana e Kolegjit të zërave përbërës të analizës financiare të kryer nga Komisioni, për elementet e trajtuar si në vijim:

4. Lidhur me shkakun ankimor mbi ligjshmërinë e burimeve të huadhënësit ***.***. për të dhënë shumën 30.000 euro hua, si një nga burimet e deklaruara për këtë pasuri me vlerë 60.800 euro, në mënyrë të përmbledhur, parashtrojmë si vijon:

4.1 Në D.-Vetting dhe në DV-2005, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi në Tiranë, me sipërfaqe totale 121,6 m², me kontratë sipërmarrje në vitin 2005, vlera: 60.800 euro dhe një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie në të dy deklaratat e mësipërme, subjekti ka deklaruar dhe: 30.000 euro, të marra hua.*

4.2 Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë burim të deklaruar, Komisioni pasi ka administruar provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetjeve të pyetësorit nr. 2², ka vlerësuar se [...] *duket se personi tjetër i lidhur, ***.***., ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas në vlerën 30.000 euro, me burim të ligjshëm nga mjetet monetare të shoqërisë [...].*

4.3 Komisioneri Publik, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se verifikimi i mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit ***.***., për të dhënë huanë në shumën e deklaruar prej 30.000 euro, duhej analizuar nga Komisioni në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

¹ Kolegji ka elaboruar këtë qëndrim në jurisprudencën e tij, të pasqyruar në disa vendime, referohuni vendimit (JR) 26/2023, prgr., 12.3 i tij, ku citohet dhe arsyetimi i vendimiy (JR) nr.15/2020 lidhur me këtë qëndrim.

² (i) vendim datë *.1.2005, i Asamblesë së ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k. për dhënie huaje; (ii) kontratë shitblerje, datë *.3.1998, (iii) lëvizje bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. gjatë vitit 2005 pranë ***-së; (iv) korrespondencë me DRT Vlorë.

4.4 Nga aktet në dosje, ka rezultuar se fitimi i realizuar nga shoqëria “***” sh.p.k.³, për të cilin janë paguar detyrimet tatimore, në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm, duke plotësuar kështu kërkesat e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr.84/2016, referuar shkresës së D.R.T Vlorë⁴ konfirmohet se për vitet 1994-1996, është në shumën 572.180 lekë, ndërsa për vitet në vijim deri në dhënien e huasë, sipas të njëjtës shkresë, konfirmohet vetëm xhiro e deklaruar dhe jo fitimi i subjektit tregtar.

4.5 Aktet e vëna në dispozicion nga D.R.T Vlorë, shkresë nr.***/* prot., datë **.8.2020, drejtuar Komisionit, mbi qarkullimin/xhiron të shoqërisë “***” sh.p.k, për vitin 2004 (*një vit përpara dhëniës së huasë*), kanë bashkëlidhur deklaratat mujore të subjektit tregtar, në të cilat është deklaruar *qarkullimi/xhiro mujore*, për vitin 2004 në shumën 2.193.258 lekë, çka duket se nuk justifikon plotësisht shumën e deklaruar dhënë hua. Ndërsa për vitin 2005, po nga korrespondenca me D.R.T. Vlorë, rezulton se shoqëria “***” nuk ka depozituar pasqyra financiare, ka deklaruar të ardhura (xhiro e aktivitetit) në masën 6.300.000 lekë dhe ka kryer pagesë të tatim-fitimit të thjeshtuar dhe taksave vendore në masën 57.200 Lekë, por nuk ka të dhëna mbi fitimin e realizuar.

4.6 Bazuar në kërkesën e Komisionit mbi vënien në dispozicion të detajeve dhe analizës mbi llogarinë e aksionerit për periudhën e kërkuar, kjo drejtori ka konfirmuar se, nisur nga fakti se ndaj kësaj shoqërie nuk është ushtruar kontroll tatimor, kjo drejtori nuk mund të shprehet për ndonjë analizë të llogarisë së aksionerit, sikundër kërkuar.

4.7 Komisioneri Publik vlerëson se konkluzioni i Komisionit mbi *burimet e ligjshme të personit tjetër i lidhur*, ***. ***, për dhënien e huasë në vlerën 30.000 euro⁵, me burim të ligjshëm nga mjetet monetare të shoqërisë, në gjendjen që janë aktet në dosje, duket se mbetet i paprovuar, për sa kohë që gjatë hetimit nuk u dokumentua raportimi dhe pasqyrimi i kësaj vlere monetare në ndonjë akt financiar kontabël të shoqërisë, sipas legjislacionit të zbatueshëm.

4.8 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe vendimi i ortakëve të shoqërisë “***” sh.p.k. i datës **.1.2005, i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigjen shtesë të pyetësorit nr. 2, vlerësohet se duhet të merret me rezervë, për sa kohë që ky vendim nuk rezultoi i depozituar pranë QKB-së, sikundër duket se ka bërë ky subjekt tregtar me vendimet e tjera të ortakëve të marra ndër vite, të cilat mbajnë numër rendor nga 1 (vendim i vitit 1999) në nr.6 (vendim i vitit 2006), dhe subjekti tregtar nuk provoi as pasqyrimin e kësaj huaje në akte të tjera kontabël të shoqërisë. Duket se ky vendim, dhe në aspektin formal, nuk plotëson vlerën ligjore të legjitimitetit të tij.

4.9 Po ashtu, edhe kontrata mbi shitjen e një pasurie të huadhënësit në vitit 1998, e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, përveçse duket një burim i ndryshëm nga ai i pretenduar nga subjekti mbi të ardhurat e shumës së dhënë hua nga huadhësi, vlerësohet se nuk provon burimin e pretenduar, për sa kohë që e ardhura në këtë kontratë në vlerën prej 1.950.000 lekë është në një vlerë më të ulët se huaja prej 30.000 euro.

³ Në këtë shoqëri, huadhënësi është ortak dhe është shoqëri nga e cila deklarohet se është siguruar shuma e dhënë hua.

⁴ Referuar shkresës drejtuar subjektit të rivlerësimit nr. ***/*, datë **.01.2020

⁵ Konvertuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë rreth 3.6 milion lekë.

5. Lidhur me shkakun ankimor mbi analizën financiare përfshirë dhe shlyerjet e huasë së sipërcituar për mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve (përfshirë dhe shlyerjet e huasë së sipërcituar) të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003-2016.

5.1 Nga aktet, rezulton se Komisionit, fillimisht nga analiza financiare e kryer në lidhje me verifikimin e mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të për periudhën 2003-2016, i ka rezultuar se ato nuk mbulojnë me burime të ligjshme, shpenzimet, investimet dhe kursimet, për një diferencë negative në vlerën prej – 1.106.588 lekë, për të gjithë periudhën e deklarimit.

5.2 Pas vlerësimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, mbi kundërshtimin e një pjese të zërave përbërës të analizës financiare, Komisioni, në përfundim, ka konkluduar se pamjaftueshmëria e konstatuar për periudhën 2003-2016 reduktohet për një diferencë negative në vlerën prej – 607.922 lekë.

5.3 Komisioneri Publik, për sa më sipër sikundër ka trajtuar dhe në ankim, konstaton nevojën për rikryerje të analizës financiare dhe rivlerësim të zërave përbërës të saj në përputhje me jurisprudencën e deritanishme, konkretisht:

5.3.1 Rishikimin dhe rivlerësimin në analizën financiare të zërit “kursime të vitit/cash” dhe llogaritjen në analizën financiare bazuar në deklaratat e subjektit dhe personave të lidhur me të, në deklaratat periodike vjetore dorëzuar në ILDKPKI. Komisioneri Publik, sjell në vëmendje jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit lidhur me kursimet në cash, se këto të fundit, nisur për vetë nga natyra e tyre, duhet të llogariten sikundër deklarohen nga vetë subjektet e rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, të cilat, në kuadër të këtij procesi, marrin vlerën e provës dhe Komisioni nuk duhet të prezumojë dhe llogarisë kursimet në cash sipas pretendimeve të subjekteve përgjatë hetimit administrativ, disa vite më vonë nga deklarimi i tyre në organet përgjegjëse (ILDKPKI).

5.3.2 Rishikimin dhe rivlerësimin në analizën financiare të zërave “të ardhura të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit” dhe “të ardhura të subjektit të rivlerësimit”, për vitet e analizuara 2003-2016, duke marrë në konsideratë të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, (i) në formën e pagave, (ii) dietave, (iii) honorareve, (iv) shitje/të drejta autori apo (v) të ardhura në formën e qirasë, të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës;

5.3.3 Rishikimin dhe rivlerësimin në analizën financiare të zërit “shpenzime jetesë”, për vitin 2007 bazuar në standartin e përcaktuar nga INSTAT për ILDKPKI, sipas shkresës nr. *** prot., datë **.3.2019 e ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare të subjektit, akt në të cilin rezulton e mbështetur dhe jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit;

5.3.4 Rishikimin dhe rivlerësimin në analizën financiare të zërit “shpenzime udhëtimi” për vitet e analizuara 2003-2016, llogaritjen e këtyre shpenzimeve në analizën financiare bazuar në të dhënat e raportit të hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS, për subjektin e rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes, referuar deklaratimeve të subjektit, si në deklaratat periodike vjetore dorëzuar në ILDKPKI, ashtu edhe gjatë hetimit administrative, si edhe mbështetur në metodologjinë orientuese të Kolegjit në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019.

5.3.5 Rishikimi i zërave përkatës të analizës financiare, si më sipër, do të ndikonte eventualisht në evidentimin e pamjaftueshmërisë financiare të viteve respektive, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, investimet dhe kursimet në cash, përtej asaj të konstatuar nga Komisioni.

II. Kontrolli i aftësive profesionale

6. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, rezulton se Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka analizuar ankesën nr.*** prot., datë **.6.2014, të përmendur në raportin e organit ndihmës, në kapitullin: *“Të dhëna arkivore të KLD-së”*, informacion nga Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, mbi cenimin e vendimit nr. ***, datë **.9.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.12.2013, të Gjykatës së Lartë.

6.1 Nisur nga fakti se informacioni ka ardhur nga raportimi i kryetarit të gjykatës, inspektorët e KLD-së⁶, bazuar në nenin 34/2 të rregullores *“Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”*, ndër të tjera, kanë vlerësuar [...] *(1) vendimi penal nr. ***, datë **.9.2013, t’u evidentohet gjyqtarëve ***, ***, ***, dhe ***, ***, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të tyre [...]. Nga aktet e përcjella nga KLGJ-ja ka rezultuar se:*

6.1.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.5.2013, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës. Caktimin e masës së sigurimit ‘arrest me burg’ ndaj shtetasit ***, ***, i biri i ***, dtl. **.5.1957, banues në Vlorë”*.

6.1.2 Mbi ankimin e paraqitur nga mbrojtësi, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.***, datë **.6.2013, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr.***, datë **.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, çdo të hënë të parë të çdo muaji, ora 12.00”*

6.1.3 Mbi rekursin e prokurorit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë **.12.2013, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr.***, datë **.6.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.***, datë **.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”*.

6.1.4 Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se [...] *në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Vlorë është vënë në dijeni të vendimit nr. ***, datë **.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka deklaruar ikjen e shtetasit ***, ***, në të tilla rrethana, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë çmohet nga ana e këtij Kolegji se është marrë në kundërshtim të hapur dhe me përcaktimet e nenit 228/3/b të Kodit të Procedurës Penale dhe me Vendimin Unifikues nr.7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë[...].*

6.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur mesa më lart, ndër të tjera, është shprehur se [...] *Nga aktet procedurale të Gjykatës së Lartë konstatohet se vendimi për deklarimin e ikjes përmendet vetëm në fjalën e prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme para Gjykatës së Lartë dhe nuk është aspak i administruar në dosje, madje, në dosje nuk ka asnjë akt tjetër shkresor për të vërtetuar ekzistencën e kësaj të dhëne. Shkaku i evidentuar nga Gjykata e Lartë nuk lidhet me*

⁶ Referohuni materialit të përgatitur nga inspektorët e KLD-së z. ***, ***, dhe z. ***, ***, *“Relatim mbi verifikimin e informacionit të paraqitur nga kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë”*, drejtuar zëvendëskryetarit të KLD-së.

zbatimin e ligjit, por dukshëm lidhet me vlerësimin e një rrethane që nuk i është nënshtruar fare hetimit gjyqësor e konkretisht të një vendimi mbi deklarin e ikjes. Kjo rrethanë nuk është pretenduar as në rekurs prej prokurorit [...].

6.3 Nga përmbajtja e vendimit, duket se, për këtë çështje të trajtuar gjatë hetimit administrativ, qëndrimi i trupës së Komisionit është *ometuar*, mungon, duke mos analizuar eventualisht pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në raport me përmbajtjen e dispozitave të neneve 245-249 të K. Pr. Penale, referuar dhe vendimit të ndërmjetëm datë **6.2013, që ka marrë vetë trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Vlorë.

6.4 Po ashtu, nuk duket se Komisioni ka analizuar faktin se, nga aktet në dosje, rezulton se në fletëthirrjet e dërguara nga Gjykata e Apelit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe fletëthirrjes së dërguar në banesën e shtetasit ***.***. për zhvillimin e seancës, fletëthirrje që mbajnë datën **6.2013, gjenden respektivisht këto dy shënime “*nuk ndodhet në paraburgim*” dhe “*larguar nga kjo adresë*”. Këto fletë thirje janë pjesë e dosjes gjyqësore në fjalë, administruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Sa më sipër, Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet në dosje, vëren se mbeten për t’u provuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

III. Kërkimi i ankimit

Mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke disponuar çeljen e hetimit dhe marrjen e provave përkatëse, sipas kërkimeve të ankimit dhe kësaj parashprese.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA